

VENDIM
Nr. 275 , datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.644, DATË 16.6.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË MASËS SË
TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE E TË TEKNIKËVE
FLUTURUES TË NJËSISË SË TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTER, NË
PENSION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr.644, datë 16.6.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Piloti/tekniku i interesuar, për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, plotëson kërkesën për përfitim nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj